

“STUDIO MODERNA ALBANIA” sh p k

Pasqyrat Financiare

Per periudhen 1 Janar 2019 deri me 31 Dhjetor 2019

NIPT: K32208001C

Adresa: Rr. “Sami Frasher”,
Perballe Drejtorisë se Policise
Tirane



RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Ortakut te Vetem te Shoqerise

“STUDIO MODERNA ALBANIA” shpk
Ruga “Sami Frasher”, Tirane, Shqiperi

Opinioni

Ne kemi audituar Pasqyrat financiare bashkelidhur te Shoqerise “Studio Moderna Albania” shpk Tirane, te cilat perfshijne pasqyren e pozicionit financier me date 31 Dhjetor 2019, pasqyrat perkatese te te ardhurave gjitheperfshirese, pasqyren e ndryshimit te kapitaleve te veta dhe pasqyren e flukseve te parase per vitin qe mbyllte ne kete date, si dhe nje permblehdje te politikave kontabel me te rendesishme.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare bashkëlidhur, në të gjitha aspektet materiale, jepin një pamje te vertete dhe te sinqerte per pozicionin financier te shoqerise “Studio Moderna Albania” shpk me 31 Dhjetor 2019, dhe te performancën financiare dhe flukset e parase per ushtrimin qe mbyllte ne kete date te cilat jane pergatitur ne perputhje dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqiperi, dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencia e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.


Informacione të tjera

Në lidhje me auditimin tonë te pasqyrave financiare, përgjegjesia jonë është te lexojmë informacionet e tjera dhe duke bërë këtë, të konsiderojmë ndërsa informacioni tjetër është dukshëm jo konsistent me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra gjatë auditimit, ose dukshëm janë paraqitur me anomali materiale. Në qoftë se bazuar ne punën qe ne kemi kryer, ne arrimë ne konkluzion se gjenden anomali materiale në keto informacione, ne kerkojmë të raportojmë kete fakt. Ne nuk kemi gjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të te permiresuara, dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Inter BBK Auditing shpk



Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjese e një auditimi ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit (SNA), ne ushtrojme gjykim profesional dhe ruajme skepticizmin profesional gjate auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojme dhe vleresojme rezikun e gabimeve materiale te pasqyrave financiare, qofte per shkak te mashtimit apo pasaktesive, planifikojme dhe kryejme procedurat e auditimit, qe u perqigjen ketyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi, qe jane te mjaftueshme dhe te pershatshme per bazat e opinionit tone. Rreziku i moszbulimit te një keqdeklarimi material, qe vjen nga mashtimi eshte me i larte se ai qe vjen nga gabimet, sepse mashtimi mund te perfshi marreveshje te fshehta, falsifikim, mosperfshirje te qellimshme, keqparaqitje, apo tejkalim te kontrollit te brendshem.
- Sigurojme një njojje te kontrollit te brendshem te pershatshem per auditimin me qellim hartimin e procedurave te auditimit, qe jane te pershatshme per rrethanat, por jo per qellim te shprehjes se një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te njesise ekonomike.
- Vleresojme pershatshmerine e politikave kontabel te perdonura dhe arsyeshmerine e vleresimeve kontabel dhe shenimeve shpjeguese te bera nga drejtimi.
- Nxjerrim perfundime mbi pershatshmerine e perdonimit nga drejtimi te parimit te vijimesise ne kontabilitet dhe, duke u bazuar ne evidencen e marre gjate auditimit, nese një pasiguri materiale ekziston ne lidhje me ngjarjet ose rrethanat qe mund te hedhin dyshime domethenese mbi aftesine e njesise ekonomike per te vazhduar ne kushtet e vijimesise se biznesit. Nese arrijme ne perfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi te detyruar te terheqim vemandjen ne raportin tone te audituesit per paraqitjen e ketij informacioni ne shenimet shpejguese te pasqyrave financiare ose, nese keto shenime jane te papershatshme, per te modifikuar opinionin tone.
- Ne rastet e një misioni per auditimin e një grapi, marrim evidenca auditimi, qe jane e mjaftueshme dhe te pershatshme per te dhenat financiare te njesive ekonomike ose aktiviteteve tregtare brenda grupit per te shprehur një opinion per pasqyrat financiare te grupit. Ne jemi per gjigjes per drejtimin, mbikëqyrjen dhe cilesine e auditimit te grupit. Ne jemi te vetmit per gjegjes per opinionin e auditimi.



Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana në të ardhmen mund të detyrojë njesinë ekonomike të mos vazhdojë më në kushtet e vijimësisë së biznesit.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje në lidhje me, midis çështjeve të tjera, qëllimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brëndshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Inter BBK Auditing shpk

Tirane me, 12 Korrik 2020

Esmeralda Balluku

Audituese Ligjore



Inter BBK Auditing
Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 32,
Hyrja 14, Ap 8
Tirane, Shqiperi

Inter BBK Auditing shpk

STUDIO MODERNA ALBANIA SHPK

Pasqyra e pozicionit finanziar me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

AKTIVET	Shenime	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Aktive Afatshkurtera			
Mjete Monetare	5	29,829,071	24,565,198
Të drejta të arkëtueshme	6	33,237,986	30,497,012
Inventari	7	158,992,596	142,178,570
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	8	1,882,944	2,556,947
Aktive totale afatshkurtra		223,942,596	199,797,727
Aktive Afatgjata			
Aktive materiale	9	45,748,749	51,219,729
Aktive totale afatgjata		45,748,749	51,219,729
TOTALI AKTIVEVE		269,691,345	251,017,456
DETYSIME DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra	10	200,284,483	159,367,145
Provizione afatshkurtra	11	14,868,679	-
Totali Detyrimeve Afatshkurtera		215,153,162	159,367,145
Detyrimet Afatgjata	12	-	4,537,779
Totali Detyrimeve Afat-gjata		-	4,537,779
Detyrime totale		215,153,162	163,904,924
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali nenshkuar	12	100,000	100,000
Fitime e pasperndara	12	1,046,547	1,046,547
Fitime/Humbje te vitit finanziar	12,18	53,391,636	85,965,985
Totali i Kapitalit		54,538,183	87,112,532
TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		269,691,345	251,017,456

Pasqyrat Financiare duhet te lexohen se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 2-24
Pasqyrat Financiare dhe Shenimet Shpjeguese jane aprovuar dhe firmosur me 20, 06, 2020 nga:

Pregatitur nga:
Erisa Dervishi

Erisa Dervishi

Bey

Administrator:
Sendi Kastrati

Sendi Kastrati
"STUDIO MODERNA ALBANIA"
TIRANA - ALBANIA

STUDIO MODERNA ALBANIA SHPK

Pasqyra e performances per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

	Shenime	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura të shfrytëzimit	13	939,182,788	944,189,926
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	14	1,102,660	263,104
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	15	(567,309,812)	(538,732,042)
Shpenzime te Personelit	16	(119,633,293)	(119,422,514)
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	17	(179,396,737)	(176,785,561)
Renja ne vlera (zhvleresimi) dhe amortizimi	9	(11,555,522)	(11,086,862)
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		62,390,085	98,426,051
Te ardhurat financiare	18	3,625,540	6,591,878
Shpenzimet financiare	18	(509,711)	(1,210,524)
Totali i te ardhurave e shpenzimeve financiare		3,115,829	5,381,354
Fitimi (humbja) para tatimit	19	65,505,914	103,807,405
Shpenzimet e tatimit te fitimit	19	(12,114,277)	(17,841,420)
Fitimi/Humbja e vtit	19	53,391,636	85,965,985

Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne
veprimtari te huaja

I cili perfshin:

Pjesa e fitimit per aksioneret e shoqerise meme

Pjesa e fitimit per aksioneret e pakices

**Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per
periudhen/vitin (A+B)**

Qendra Jevusha
Rey

Siguri Kostafa



STUDIO MODERNA ALBANIA SHPK

Pasqyra e fluksit te mjetete monetare per 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitim/ Humbja e vitit	53,391,636	85,965,985
Rregullime per:		
Amortizimi dhe zhvleresimi	(11,555,522)	(11,086,862)
(Rritja)/ Ulja e inventareve	(16,814,026)	(34,629,881)
(Rritja) / Ulja e te keresave te arketueshme	(2,740,974)	13,340,887
(Rritja) / Ulja e te kthyeshmeve te tjera	674,003	2,124,162
Rritja/(Ulja) e detyrimeve per tu paguar	40,917,338	46,886,706
Rritja / (Ulja) te pagueshmeve te tjera	14,868,679	-
<i>Paraja neto nga aktivitetet e shfrytezimit</i>	<hr/> 78,741,134	<hr/> 102,600,997
Fluksi i parave nga veprimtarite investuese		
Blerje prona dhe aktive	17,026,502	7,021,601
<i>Paraja neto nga aktivitetet investuese</i>	<hr/> 17,026,502	<hr/> 7,021,601
Fluksi i parave nga veprimtarite financiare		
Pagesat e detyrimeve afatgjate	(4,537,779)	1,183,453
Dividendet e paguar	(85,965,985)	(123,123,324)
<i>Paraja neto nga aktivitetet financiare</i>	<hr/> (90,503,764)	<hr/> (121,939,871)
Rritja/renia neto e mjetete monetare	<hr/> 5,263,872	<hr/> (12,317,273)
Mjete monetare ne fillim te periudhes ushtrimore	24,565,198	36,882,471
Mjete monetare ne fund te periudhes ushtrimore	<hr/> 29,829,070	<hr/> 24,565,198

Gjelca Devisteli



Sandër Festneci



STUDIO MODERNA ALBANIA SHPK

Pasqyra e Kapitalit Neto te Shoqerise me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

	Kapitali Nenshkruar	Rezerva Ligjore & te tjera	Fitimi i pasherndare	Totali
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	100,000	-	124,169,871	124,269,871
Kapitali aksioner i kontribuar				
Fitimi neto (Humjje) per Dhjetor 2018		85,965,985		85,965,985
Rritje e rezerves se Kapitalit		(123,123,324)		(123,123,324)
Dividende te shperndare				
Gjendja me 31 Dhjetor 2018	100,000	-	87,012,532	87,112,532
Kapitali aksioner i kontribuar				
Fitimi neto (Humjje) per Dhjetor 2019		53,391,636		53,391,636
Rritje e rezerves se Kapitalit		(85,965,985)		(85,965,985)
Dividende te shperndare				
Gjendja me 31 Dhjetor 2019	100,000	54,438,183		54,538,183

Serdar Tashkash
Jetona



Blersa Devolli
Bler

STUDIO MODERNA ALBANIA SHPK

Pasqyra e Te Ardhurave Gjitheperfshirese te Shoqerise me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

	Viti 2019	Viti 2018
Fitim/humbja e vitit	53,391,636	85,965,985
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per vitin:		
Diferencia (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja	-	-
Diferencia (+/-) nga rivleresimi i aktiveve afatgjata	-	-
Diferencia (+/-) nga rivleresimi i aktiveve financiare te mbajtura per shitje	-	-
Pjesa e te ardhurave gjitheperfshirese nga pjesmarrjet	-	-
Totali I te ardhurave te tjera gjitheperfshirese per vitin	-	-
Totali I te ardhurave githeperfshirese per vitin	53,391,636	85,965,985

Totali I te ardhurave /humbjeve gjitheperfshirese per:

Pronaret e njesise ekonomike meme

Interesat jo-kontrolluese

Ergesa Devi'shi

Shay

Selvi Kavaja

Jela



Studio Moderna Albania shpk
NIPT: K32208001C
Adresa: Rr "Sami Frasheri", perballe Drejtorese se Policise, Tirane

RAPORT I ECURISE SE VEPRIMTARISE

DATE 31 DHJETOR 2019

- **Te pergjithshme**

Shoqeria "Studio Moderna Albania" sh p k eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar me 23 Shtator 2003 dhe operon ne perputhje me ligjin Nr 9901 date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe shoqerite tregetare", i ndryshuar.

Adresa e rregistruar e shoqerise eshte: Rr" Sami Frasheri", perballe Drejtorese se Policise

- **Aktiviteti i Shoqerise**

Aktiviteti kryesor i shoqerise eshte Teleshoping, import-eksport, tregti mallrash e sherbimesh.

Kapitali i paguar i rregistruar i shoqerise eshte 100,000 Leke,i ndare ne menyre te barabarte ne 100 kuota, me vlore nominale 1,000 Leke per kuote.

Kuotat e kapitalit zoterojen ne masen 100% nga Studio Moderna Holdings Investments B.V

Shoqeria "Studio Moderna Albania" sh p k drejtohet nga administratori i shoqerise Z. Sendi Kastrati.

- **Informacion lidhur me mjedisin ku zhvillohet aktiviteti**

Shoqeria Studio Moderna Albania shpk operon ne fushen teleshoping dhe tregtimit te mallrave dhe sherbimeve.

- **Informacion lidhur me punonjesit**

Shoqeria gjate vitit ushtrimor 2019 ka patur nje numer mesatar te punonjesve rreth 140 punonjes, krahasuar me vitin 2018 me nje numer mesatar te punonjesve qe ishte 135 punonjes.

Shoqeria ka si pjese perberese te stafit te ekonomiste ,konsulent te metodave te shitjes, webmasters,nje numer te madh shitesish dhe shperndareshish te porosive.

Me 31 Dhjetor 2019 shpenzimet per personelin jane paraqitur si me poshte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Pagat dhe shpërblimet e personelit	85,713,955	86,032,722
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	33,919,338	33,389,792
Totali	119,633,293	119,422,514
Numri mesatar i punonjesve	140	135

• Risqe dhe Pasiguri Kryesore

(konkurenca e pandershme, luhatjet e kursit te kembimit, kriza ekonomike, apo fatkeqesi natyrore, etj.

Kompanite duhet të vlerësojnë faktoret e jashtem por edhe të brendshem të cilit mund të vene ne rrezik të dhënat dhe sistemet informatike. Piratët e internetit mund të thyen elementët e sigurisë së të dhënave dhe të dëmtojnë apo përdorin programet, bazë e të dhënave dhe rrjetet e krijuara.

Punonjësit mund të bëjnë me ose pa dashje gabime, duke vënë në rrezik funksionimin e sistemit dhe sigurinë e tij. Në çdo rast Shoqeria duhet të llogarisë paraprakisht vlerën e dëmit të mundshëm së bashku me probabilitetet përkatëse të ndodhjes së tij. Bazuar në një vlerësim të tij, duhet hartuar një plan i detajuar veprimi për minimizimin e ndodhjes së ngjarjeve me risk dhe minimizimin e pasojave të tyre në ato raste, kur ato nuk arrihet të parandalohen.

Shoqeria eshte e eksopozuar ndaj rrezikut nga luhatjet e kurseve te kembimit. Me poshte janë kurset e kembimit te aplikuara gjate vitit:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1 Euro	121.77	123.42
1 US Dollar	108.64	107.82

Shoqeria ka ekspozim ndaj rrezikut te monedhave te huaja si me poshte :

2019	Leke	Euro	USD	Total
Aktive afatshkurtra				
Mjete monetare	20,822,165	8,832,039	174,867	29,829,071
Te arketueshme tregtare	24,482,715	1,896,352	-	26,379,067
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	1,731,500	151,444	-	1,882,944
Totali i Aktiveve afatshkurtra	47,036,379	10,879,835	174,867	58,091,082
Detyrime afatshkurtra				
Furnitore dhe detyrime te tjera	-20,441,406	-179,654,178	-188,898	-200,284,574
Totali i Detyrime afatshkurtra	-20,441,406	-179,654,178	-188,898	-200,284,574
Pozicioni neto i kursit te kembimit	26,594,973	-168,774,343	-14,031	-142,193,493

Analiza e ndjeshmerise

Nje forcim prej 15% i Lekut ndaj Euros ne 31 Dhjetor 2019 dhe i Dollarit me 31 Dhejtor 2019 do te rriste/(ulte) kapitalet e veta dhe fitimin ose humbjen me vlerat e treguara me poshte. Kjo analize presupozon qe te gjithe indikatorët e tjere, ne vecanti normat e interesit, te jete te pandryshuara.

2019	Kapitali	Fitim/Humbja
EUR	(25,316,165)	(25,316,165)
USD	(2,105)	(2,105)

• Performanca Financiare

Treguesit ekonomiko financiar te aktivitetit te shoqerise per vitin 2019, krahasuar me vitin 2018 paraqiten si me poshte:

TREGUESIT	Viti 2019	Viti 2018
Qarkullimi Gjithsej	940,285,448	944,453,030
Fondi i Pagave	119,633,293	119,422,514
Nr mesatar i punonjesve	140	135

Qarkullimi i realizuar nga shoqeria gjate vitit 2019 krahasuar me vitin 2018 paraqitet si me poshte:

	<i>Viti 2019</i>	<i>Viti 2018</i>
Te ardhura nga shitja e mallrave	925,246,617	936,248,620
Te ardhura nga sherbimet	3,160,743	2,904,857
Te ardhura nga shitja e garancive per produktet	10,775,428	5,036,449
Te ardhura te tjera	1,102,660	263,104
Totali	940,285,448	944,453,030

Investime te kryera nga shoqeria gjate vitit 2019 krahasuar me vitin 2018 paraqiten si me poshte:

TREGUESIT	Viti 2019	Viti 2018
Blerje ndertese	625,219	1,833,717
Blerje mjete transporti	1,666,170	3,734,960
Blerje pajisje informatike	594,009	932,282
Blerje pajisje mobilje zyre	4,698,579	10,562,468
Totali	7,583,977	17,063,427

Detyrimet tatimore te paguara nga shoqeria per vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 paraqiten si me poshte:

TREGUESIT	Viti 2019	Viti 2018
T.V.SH	50,220,474	59,038,933
Tatim Fitimi	13,609,372	23,205,245
Tatim i mbajtur ne Burim	6,855,421	10,150,835
Sigurime Shoqerore & Shendetesore	33,919,338	33,392,170

- **Ekzistencën e degëve të Studio Moderna Albania shpk, nese ka**
Shoqeria operon si shoqeri me per gjigjegjesi te kufizuar dhe nuk ka dege.
- **Instrumenteve financiare nga ana e njësisë ekonomike dhe kur është materiale përvlerësimin e aktiveve, detyrimeve, pozicionit financiar, fitimit dhe humbjes, nese ka**

Një instrument finanziar është çdo kontratë që krijon një aktiv finanziar të një njësie ekonomike dhe një pasiv finanziar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre dhe llogari te pagushme tregetare dhe të tjera.

Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqerise përfshijnë llogaritë e arkëtueshme dhe te tjera, mjete monetare, dhe detyrimet tregtare dhe të tjera.

Shoqeria nuk ka aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, të mbajtura deri në maturim ose të vlefshme përshtitje.

- **Politikat dhe objektivat e menaxhimit të riskut financiar**

Politikat e Shoqerise per manazhimin e rrezikut kane per qellim te identifikojnë, analizojnë, menaxhojnë rreziqet me te cilat perballët shoqeria, te percaktojnë kufijtë e rrezikut, te vendosin kontolle per te mbikqyrur

riskun ne kufijte e percaktuardhe te sigurojne permes monitorimit qe ekspozimi ndaj rreziqeve te qendroje brenda ketyre kufijve. Politikat dhe procedurat per manaxhimin e riskut rishikohen rregullisht per te pasqyruar ndryshimet ne kushtet e tregut, produktet dhe sherbimet e ofruara dhe paraqitjen e praktikave te perditesuara.

Pasqyrat financiare te shoqerise perqatiten mbi parimin e vijimesise i cili merr ne konsiderate se Shoqeria do te vazhdoje egzistencen e aktivitetit te saj ne nje te ardhme te parashikuar.

- Ekspozimin e njësisë ekonomike ndaj riskut të çmimit, riskut të kreditit, riskut të likuiditetit dhe riskut të flukseve monetare.**

a. Risku i likuiditetit

Me 31 Dhjetor 2019, struktura e maturimit te detyrimeve financiare te shoqerise bazuar ne pagesat e paskontuara eshte paraqitur si me poshte:

2019	0-6 Muaj	6-12 Muaj	Nga 1 ne 5 vite	Totali
Detyrime financiare				
Detyrime ndaj furnitoreve	-	184,410,569	-	184,410,569
Detyrimet ndaj punonjesve dhe tatimore	15,314,459	-	-	15,314,459
Detyrime karta krediti	-	559,455	-	559,455
Totali	15,314,459	184,970,024	-	200,284,483

b. Risku kreditor

Me 31 Dhjetor 2019, struktura e maturimit te llogarive te arketueshme te shoqerise bazuar ne pagesat e paskontuara eshte paraqitur si me poshte:

2019	0-6 Muaj	6-12 Muaj	Me shume se 12 muaj	Totali
Aktive financiare				
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	29,829,071	-	-	29,829,071
Te drejta te arketueshme	-	26,379,067	-	26,379,067
Totali	29,829,071	26,379,067	-	56,208,138

c. Reziku nga normat e interesit

Te ardhurat dhe flukset monetare e shoqerise jane te pavarura nga ndryshimet ne normen e interesit ne treg. Shoqeria nuk disponon aktive me vlore materiale, shuma e te cilave varet nga norma e interesit.

Ju Faleminderit

Tirane me 20/06/ 2020

Administrator

Sendi KASTRATI



“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

1. Te pergjithshme

Shoqeria “Studio Moderna Albania ” sh p k eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe data e themelimit te saj eshte 23.09.2003, me Seline Rruga “Sami Frasher”, perballë Drjetorisë Policise, Tirane.

Shoqeria “Studio Moderna Albania” sh p k eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitiveve perkate te Ligjit 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambiente qe jane ne pronesi dhe me qera te marra prej saj. Aktivet e Qendrueshme prone e saj perbehen nga ndertesa, mjetet e transportit pajisje pune dhe pajisje kompjuterike.

Shoqeria ka per objekt: Teleshoping,import-eksport,tregti mallrash e sherbimesh,si dhe cdo lloj tjeter aktiviteti ne perputhje me ligjin.

Kapitali i shoqerise sipas depozitimeve te kryera ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit perbehet nga kontributet e aksionereve :

Studio Moderna Holdings Investments B.V. 100.00 % te kuotave

ne shumen totale prej 100,000 leke. (njeqind mijë)

Shoqeria “Studio Moderna Albania” shpk drejtohet nga administrator Z. Sendi Kastrati .

2. Politikat kryesore kontabile

2.1 Bazat e pergatitjes

Deklarimet financiare te bashkangjitura jane pergatitur ne baze te rregjistimeve kontabel te mbajtura per qellime te kontabilitetit te vendit konform Ligji 25/2018 date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Pasqyrat Financiare te fund vitit jane paraqitur ne formatin e paraqitur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne fuqi (SKK 2) i permiresuar.

Referuar klasifikimit te subjektit sipas ligjit 25/2018 date 10.05.2018, subjekti klasifikohet si njesi ekonomike e mesme.

Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqiperi deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave Financiare ne perputhje me kerkesat e SKK, kerkon perdorimin e disa vleresimeve kontabile te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe manaxhimi i Shoqerise te jape gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile te saj. Fushat te cilat kerkojne një shkalle te larte ose komplekse te gjykimit ose ato per te cilat vleresimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

2. Politikat kryesore kontabile (vazhdim)

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njihen ne te njejtene periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekonomike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet. Mbajtja e kontabilitetit, i cili perfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar, me ane te nje programi te kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha shqiptare.

Nje permblehdhe te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

2.2 Instrumentat financiare

Kompania ka vetem instrumenta financiare jo derivative, perfshire dhe kerkesa nga klienti dhe kerkesa te tjera, mjete likuide dhe te ngjashme me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe te tjera detyrime.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen, fillimi, me vleren e drejte plus, qdo kosto te drejtperdrejte transaksiuni te lidhura me to, pavec atyre te pershkruara me poshte. Ne vazhdim te njoftues fillestare instrumentat financiare vleresohen si me poshte.

Nje instrument finanziar njihet nese kompania eshte pale ne kushtet e kontrates. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat e Kompanise mbi rrejdhate ardhshme te parase te gjeneruara nga aktivi financier kane mbaruar ose nese kompania i transferon aktivite financiare nje pale te trete pa mbajtur te drejtat e kontrollit ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet nga aktivi. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohet ne daten e shitblerjes psh. daten ne te cilin kompania vendos vete te bleje apo te shese aktivet. Detyrimet financiare nuk njihen me nese detyrimet e Kompanise e specifikuara ne kontrate mbarojne afatin ose shlyen ose anullohen.

Mjetet Monetare

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurteria jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e kostos se tyre minus provisionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te lejuara mund te llogariten, per shumat e vleresura si te rikuperueshme, ne fitim humbje kur ekziston nje evidence objektive qe keto kerkesa jane zhvleresuar me pare.

Detyrime te pagueshme

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

2. Politikat kryesore kontabile (vazhdim)

Huate bankare dhe te tjera

Ne vazhdim te njojhes fillestare, huate bankare dhe te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njojur çdo diferenca midis kostos dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interes efektiv.

Te tjera

Te tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto te amortizueshme duke perdorur metoden e interest efektiv, minus cdo humbje nga zhvleresimi.

Kontabilizimi i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare sqarohet ne piken 2.8.

Aktivet financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra pervec rasteve kur kompania ka te drejte te pakushtezuar te ndryshoje marreveshjen e huase per te pakten 12 muaj pas dates se bilancit.

2.3 Inventaret

Shoqeria zoteron inventare per vitin 2019.

Inventaret maten fillimish me kosto. Pas njojhes fillestare te tyre Shoqeria vlereson inventarin me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten e mbylljes se bilancit. Shuma e Zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ka faktore ojektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresuar. Metoda e vleresimit eshte hyrje e pare – dalje e pare (FIFO).

2.4 Aktivet Afatgjata Materiale

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Aktivet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit per ndertesa dhe instalimet teknike eshte metoda lineare e cila merr ne konsiderate jeten e dobishme ekonomike, ndersa amortizimi per AAM te tjera llogaritet mbi bazen metodes zbritese si dhe duke marre ne konsiderate daten e venies ne perdonim te tyre.

Me date 31 Dhjetor 2019 normat e amortizimit te perdonura paraqiten:

□ Ndertesa	20.00 %	menyre zbritese
□ Mjete Transporti	20.00%	menyre zbritese
□ Mobilje dhe paisje zyre	20.00%	menyre zbritese
□ Paisje informative	25.00%	menyre zbritese

Toka dhe Ndertimet ne Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerra jashte perdonimit percaktohen nga krahasimi i perfitimeve me vleren e tyre kontabel. Keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

2. Politikat kryesore kontabile (vazhdim)

2.5 Aktivet Afatgjata Jo-Materiale

Per vitin 2019 shoqeria nuk zoteron Aktive Afatgjata Jo Materiale. AAJM njihet fillimi si me koston qe perbehet nga çmimi i blerjes dhe kosto te tjera qe lidhen drejtperdrejt me blerjen.

AAJM paraqitet ne bilanc me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi

2.6 Kuotat e kapitalit

Kuotat e thjeshta njihen si kapital. Kuota njihet me vleren nominale.

2.7 Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabile te aktiveve jofinanciare te Kompanise, pervec inventareve dhe tatimeve te shtyra rishikohen ne cdo date raportimi per te pare nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese ekziston ndonje tregues i tillë atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabile e një aktivi eshte me madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi eshte me e madhja mes vleres se tij ne perdonim dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Ne matjen e vleres ne perdonim, flukset e pritshme te parase skontohen ne vleren e aktuale duke perdonur normen e skontimit perpara takses qe paraqet vleresimin e tregut per vleren ne kohe te parase dhe riskun specifik te aktivit.

Per humbjet nga zhvleresimi te njoitura ne periudhat e meparshme vleresohet ne cdo date raportimi nese ka ndonje tregues sipas te cililumbja eshte ulur ose nuk ekziston me. Nje humbje nga zhvleresimi anullohet nese kane ndodhur ndryshimet ne vleresimet e bera per percaktaqimin e vleres se rekuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi anullohet deri ne ate mase qe vlera kontabel e aktiveve te mos kaloje vleren kontabel te aktiveve, minus amortizimin, qe do te ishte percaktuar nese zhvleresimi nuk do te kishte ndodhur.

2.8 Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv finanziar zhvleresohet nese ekzistojne tregues sipas te cileve nje ose disa ngjarje kane pasur nje ndikim negativ ne vleresimin e fluksesve te ardhshme te parase prej atij aktivi.

Humbja nga zhvleresimi ne rastin e një aktivi finanziar te vleresuar me kosto te amortizuar llogaritet si diferenca midis vleres kontabel (neto) dhe Vleres aktuale te flukseve te pritshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive financiare te nje rendesie te vecante testohen per zhvleresim ne menyre te vecante. Pjesa tjeter e aktiveve vleresohen se bashku, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Humbja nga zhvleresimi mund te anullohet nese ajo mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pasi njoftes se zhvleresimit. Per aktivet financiare te vlersuara ne kosto te amortizuara anullimi i zhvleresimit njihet ne fitim humbje.

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

2. Politikat kryesore kontabile (vazhdim)

2.9 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përvèç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vleren e drejte te përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga dhenia e te drejtës per perdorim e emrit nanfranshizuesve.

Te ardhurat perfshijne shumat neto pa perfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, te cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i pronesise se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek bleresi.

2.10 Shpenzimet

Pagesat per qerata

Pagesat e kryera si qera e zakonshme njihen ne shpenzime te periudhes ne baze lineare duke u mbeshtetur ne kushtet e qerase.

Shpenzimet

Shpenzimet jane njohur mbi bazën e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet per kerkime e zhvillime per gjithësisht jane ngarkuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

2.11 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare permblledhin te ardhurat nga interesit nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktive financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesit njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huata, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet e aktiveve financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazën e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

2.12 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatumore përmban shpenzimin tatumor aktual (të ardhurën tatumore aktuale) dhe shpenzimin tatumor të shtyrë (të ardhurën tatumore të shtyrë). Shpenzimet qe lidhen me tatin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

2. Politikat kryesore kontabile (vazhdim)

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e viti ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne diten e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit te bilancit, duke marre si diferenca te perkozhshme differencat midis bazës tatimore te një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkozhshme do te zhduket.

Kompania njeh aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatushme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatushëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm pëtë lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatushëm të mjaftueshëm.

2.13 Transaksionet me monedhat e huaja

(a) Monedha e perdorur dhe raportuese

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grüp maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdom). Pasqyrat e financiare raportohen ne LEKE shqiptar (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

(b) Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

	31 Dhjetor 2019	29 Dhjetor 2018
1 Euro	121.77	123.42
1 US Dollar	108.64	107.82

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

3. Manaxhimi i rrezikut finansiar

Manaxhimi i rrezikut finansiar eshte nje element i rendesishem ne aktivitetin e Shoqerise. Rreziqet kryesore me te cilat perballat Shoqeria jane ato qe lidhen me rrezikun e tregut, i cili perfshin rrezikun e çmimit, te normes se interesit dhe te kursit te kembimit, rrezikun e kredise dhe rrezikun e likuiditetit.

3. Manaxhimi I rrezikut finansiar

3.1 Politikat dhe procedurat per manaxhimin e rrezikut

Politikat e Shoqerise per manaxhimin e rrezikut kane per qellim te identifikojne, analizojne, menaxhojne rreziqet me te cilat perballat Shoqeria, te percaktojne kufijte e rrezikut, te vendosin kontolle per te mbikqyrur riskun ne kufijte e percaktuar dhe te sigurojne permes monitorimit qe ekspozimi ndaj rreziqeve te qendroje brenda ketyre kufijve. Politikat dhe procedurat per manaxhimin e rrezikut rishikohen rregullisht per te pasqyruar ndryshimet ne kushtet e tregut, produktet dhe sherbimet e ofruara dhe paraqitjen e praktikave te perditesuara.

Drejtimi i Shoqerise ne bashkepunim te ngushte me mbikqyrjen e strukturave te manaxhimit te riskut ka perjegjesi te plete per mbikqyrjen e kuadrit te manaxhimit te riskut, mbikqyrjen e manaxhimit te rreziqeve kryesor dhe rishikimin e politikave dhe procedurave te tij te manaxhimit te rrezikut sikurse miratimin e transaksioneve te rendesishme dhe me shuma te konsiderueshme.

Si faktoret e brendshem ashtu edhe ato te jashtem jane identifikuar dhe manaxhuar permes struktura organizative te Shoqerise,dhe veçanerisht nga strukturat e manaxhimit te riskut ne nivel grupi.

3.1.1 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut eshte rreziku i humbjes si rezultat i ndryshimeve ne çmimet e tregut, kurset e kembimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Rreziku i tregut vjen nga ekspozimi i kompanise ndaj normave te interest, kurseve te kembimit dhe elementeve te tjere te cilet jane ne ndikim te drejtperdrejte te ndryshimeve te per gjithshme dhe specifice te tregut dhe ndryshimeve ne nivelin e qendruesherise se çmimeve ne treg

Objektivi i manaxhimit te riskut te tregut eshte te menaxhoje dhe kontrolloje ekspozimin e rrezikut te tregut brenda parametrave te pranueshem.

3.1.2 Rreziku i normes se interesit

Rreziku i normes se interesit eshte rreziku qe ndryshimi ne normat e interesit mund te shkaktoje luhatje ne te ardhurat e Shoqerise ose ne vleren e portofolit te investimeve.

Te ardhurat e Shoqerise dhe flukset monetare operative jane pothuajse te pavarura nga ndryshimet ne normat e interest te tregut pasi Shoqeria nuk ka aktive financiare te cilat mbartin interes. Ndryshimet ne normat e interesit ndikojne kryesisht huamarrjet dhe huadheniet me norma interesit te ndryshueshme, duke ndryshuar flukset e ardhshme monetare. Drejtimi i Shoqerise nuk ka nje politike zyrtare te percaktimit te shumave te dhena ose te marra hua me norma interesit fikse ose te ndryshueshme. Megjithate. ne kohen e huamarrjeve te reja drejtimi perdon gjykimin e tij per te vendosur nese nje norme interesit fikse ose e ndryshueshme do te ishte me e favorshme per Shoqerine gjate periudhes deri ne maturim.

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

3.1.3 Rreziku i kursit te kembimit

Shoqeria ka aktive dhe detyrime te shprehura ne USD dhe ne Euro. Rreziku i kursit te kembimit lind kur aktivet aktuale ose te parashikuara ne nje monedhe te huaj jane me te medha ose me te vogla se detyrimet ne ate monedhe.

3. Manaxhimi I rrezikut finansiar

3.1.4 Rreziku i kredise

Rreziku i kredise eshte rreziku qe nje pale ne nje instrument finansiar te shkaktoje nje humbje financiare ndaj pales tjeter duke deshtuar ne shlyerjen e detyrimit dhe vjen kryesish si pasoje e llogarive te arketueshme te Shoqerise nga klientet e saj.

Eksposimi i Shoqerise ndaj rrezikut te kredise ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale te çdo klienti. Shoqeria ka njohur nje zhvleresim per llogarite e arketueshme qe pasqyron vleresimin e saj per humbjet e prishme ne lidhje me llogarite e arketueshme nga klientet dhe te tjera te arketueshme. Zhvleresimi eshte llogaritur mbi bazen e analizes individuale per klientet.

3.1.5 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit percaktohet si rreziku qe Shoqeria te ndeshe veshtiresi ne shlyerjen e detyrimeve te saj finansiare. Perqasja e Shoqerise per te manaxhuar likuiditetin eshte qe te siguroje aq sa eshte e mundur se do te kete gjithmone likuiditet te mjaftueshem per te shlyer detyrimet e saj kur ato kerkohen si ne kushte normale dhe jonormale pa shkaktuar humbje te papranueshme ose te rezikoje demtimin e emrit te Shoqerise.

Shoqeria sigurohet vazhdimesht se ka mjete te mjaftueshme monetare per te paguar shpenzimet e prishme operacionale, duke perfshire sherbin e detyrimeve finansiare. Kjo perjashton ndikimin e mundshem te rethanave ekstreme qe nuk mund te parashikohen si psh. fatkeqesite natyrore.

3.2 Manaxhimi i kapitalit

Objektiva e Shoqerise ne lidhje me manaxhimin e kapitalit eshte ruajtja e aftesise e saj per vijimesi te biznesit, ne menyre qe te mundesoje kthimin e perfitimeve te pritura nga aksionaret,e perfitimeve per grupe te tjera te interesit dhe per te mbajtur nje strukture optimale te kapitalit e cila redukton rastin e tij. Totali i kapitalit nen administrim eshte i barabarte me kapitalin siç tregohet ne bilancin kontabel plus borxhin neto. Borxhi neto llogaritet si huamarrjet totale siç tregohet ne bilancin kontabel minus mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre.

Shoqeria eshte financuar me kapitalin minimal dhe kryesish me huamarrje te brendshme dhe detyrime ndaj paleve te lidhura. Shoqeria meme ka konfirmuar se eshte ne politiken e saj aktuale te sigurohet se Shoqeria eshte ne gjendje te shlyeje borxhet e saj dhe angazhimet e saj per shpenzimet ne lidhje me investimet kapitale kur ato kerkohet te paguhen. Shoqeria meme ka konfirmuar gjithashtu, se do te mbeshtese per tu siguruar se Shoqeria do te kene fondet e nevojshme per te shlyer detyrimet e tyre kur ato kerkohet te paguhen.

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
 Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

4. Gjykimet dhe vleresimet kryesore kontabel

Drejtimi i Shoqerise ka perdorur gjykin e tij ne lidhje me nje sere vleresimesh e supozimesh ne lidhje me raportimin e aktiveve dhe detyrimeve dhe shpjegimin e aktiveve dhe detyrimeve te kushtezuara ne pergatitjen e pasqyrave financiare. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime. Vleresimet dhe supozimet e meposhtme rishikohen ne menyre te vazhdueshme dhe ndryshimet njihen ne periudhen ne te cilen jane bere vleresimet dhe ne periudhat e ardhshme ne te cilat keto vleresime kane ndikim.

Parimi i vijimesise

Pasqyrat financiare te shoqerise pergatiten mbi parimin e vijimesise i cili merr ne konsiderate se Shoqeria do te vazhdoje egzistencen e aktivitetit te saj ne nje te ardhme te parashikuar. Ortaket e saj gjykojne se do te bejne perpekje per financimin e shoqerise edhe nepermjet rritjes se tregut e ritjes se te ardhurave.

5. Mjete Monetare

Mjete Monetare (Likuiditetet) jane paraqitur ne bilanc me gjendjen e llogarive bankare ne fund te periudhes me date 31 Dhjetor 2019, te cilat jane te njehta me ekstrakin e fundit te bankave per kete periudhe si dhe me gjendjen e parave ne arken e Shoqerise.

	<i>31 Dhjetor 2019</i>	<i>31 Dhjetor 2018</i>
Vlera monetare bankare, në lekë	17,756,820	15,643,609
Vlera monetare, në monedha të huaja	8,899,989	3,560,556
Vlera monetare në arkë	3,172,261	5,361,033
Totali	29,829,071	24,565,198

6. Te drejta te arketueshme

Te drejtat e arketueshme me date 31 Dhjetor 2019 paraqiten si me poshte:

	<i>31 Dhjetor 2019</i>	<i>31 Dhjetor 2018</i>
Kliente	26,379,067	25,133,187
Te arketueshme te tjera	6,858,919	5,363,825
Totali	33,237,986	30,497,012

7. Inventari

Inventari ne date 31 Dhjetor 2019 perbehet nga mallrat per rishitje ne vlerat si meposhte:

	<i>31 Dhjetor 2019</i>	<i>31 Dhjetor 2018</i>
Mallra per rishitje	158,992,596	142,178,570
Totali	158,992,596	142,178,570

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

8. Parapagime dhe shpenzime te shtyra

	<i>31 Dhjetor 2019</i>	<i>31 Dhjetor 2018</i>
Parapagime të dhëna	1,531,500	1,499,219
Garanci ne lek	200,000	846,416
Network Segmentation	151,444	211,312
Totali	1,882,944	2,556,947

9. Aktive Afatgjata Materiale dhe Jomateriale

Gjate periudhes ushtrimoret e mbyllur me 31 Dhjetor 2019, sipas Bilancit Kontabel, te paraqitur jane bere kontabilizimet per blerje te Aktivet e Qendrueshme te Trupezuara. Keshtu qe Vlera neto e tyre paraqitet sa me poshte:

<i>Kosto Historike</i>	<i>Ndertesa</i>	<i>Mjete Transporti</i>	<i>Mobilje & Paisje Zyre</i>	<i>Paisje Informative</i>	<i>Totali</i>
Gjendje 01.01.2019	21,030,246	11,188,739	41,353,276	22,588,649	96,160,910
Shtesa	625,219	1,666,170	4,698,579	594,009	7,583,977
Pakesime (-)	-3,000,790	-	-1,129,530	-3,257,290	-7,387,610
Gjendje 31.12.2019	18,654,675	12,854,909	44,922,325	19,925,368	96,357,277
 <i>Amortizimi</i>					
Gjendje ne 01.01.2019	10,343,273	3,646,615	17,452,695	13,498,598	44,941,181
Shtesa llogaritur	2,027,791	1,841,659	5,361,175	2,324,897	11,555,522
Pakesime	-2,028,861	-	-891,786	-2,967,528	-5,888,175
Gjendje ne 31.12.2019	10,342,203	5,488,274	21,922,084	12,855,967	50,608,528
Vlera neto ne 01.01.2019	10,686,973	7,542,124	23,900,581	9,090,051	51,219,729
Vlera neto ne 31.01.2019	8,312,472	7,366,635	23,000,241	7,069,401	45,748,749

Shoqeria ka shtuar aktivet ne pronesi te saj te cilat jane paraqitur, vleresuar dhe kontabilizuar drejt, konform rregullave te kontabilitetit.

Amortizimi

Amortizimi i Aktiveve te Qendrueshme te Trupezuara eshte llogaritur sipas politikave kontabel te miratuara ne Shenimin 2. Llogaritja e amortizimit eshte bere per shumen 11,555,522 leke, kontabilizuar edhe ne shpenzime. Sipas llogaritjeve per efektin fiscal shoqeria ka perdonur normat ligjore te amortizimit

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
 Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

10. Detyrimet Afatshkurtra

Detyrime afatshkurtra me date 31 Dhjetor 2019 paraqiten si me poshte:

	<i>31 Dhjetor 2019</i>	<i>31 Dhjetor 2018</i>
Te pagueshme ndaj furnitoreve	184,412,697	132,173,681
Te pagueshme ndaj Punonjesve	7,716,439	14,620,724
Detyrime Tatimore	7,598,020	7,193,529
Te pagueshme te tjera	557,327	-
Totali	200,284,482	153,987,934

Ne llogaritjen e detyrimeve shoqeria ka mbajtur parasysh kerkesat e Legispcionit fiskal ne Republiken e Shqiperise, duke pasqyruar, tatimin mbi te ardhurat personale si dhe ate ne burim te llogaritur, te rregjistruar drejt dhe te papaguar per detyrimin e krijuar ne muajin Dhjetor 2019.

10.a Te pagueshme ndaj punonjesve

	<i>31 Dhjetor 2019</i>	<i>31 Dhjetor 2018</i>
Paga dhe shpërblime	2,830,253	8,668,388
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	4,886,186	5,952,336
Totali	7,716,439	14,620,724

10.b Detyrime Tatimore

	<i>31 Dhjetor 2019</i>	<i>31 Dhjetor 2018</i>
TVSH për tu paguar	7,407,995	5,646,781
Tatim I mbajtur ne burim	190,025	1,546,748
Totali	7,598,020	7,193,529

11. Provizone afatshkurtra

Provizonet afatshkurtra me date 31 Dhjetor 2019 paraqiten si me poshte:

	<i>31 Dhjetor 2019</i>	<i>31 Dhjetor 2018</i>
Provizone Afatshkurtra	14,868,679	5,379,211
Totali	14,868,679	5,379,211

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
 Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

12. Kapitali

Kapitali themeltar, Rezerva, Fitim e Humbje me date 31 Dhjetor 2019 paraqiten si me poshte:

	<i>31 Dhjetor 2019</i>	<i>31 Dhjetor 2018</i>
Kapitali Aksioner/nenshkruar	100,000	100,000
Fitime e pashperndara	1,046,547	1,046,547
Fitime/Humbje te vitit finanziar	53,391,636	85,965,985
Totali	54,538,183	87,112,532

Sipas vendimit te ortakeve date 28.05.2019, ne Amsterdam, u miratua sheperndarja ne forme dividendi e fitimit neto te vitit 2018 perkatesisht ne vleren 85,965,985 leke

13. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Ne kete ze perfshihen te ardhurat si me poshte:

	<i>Viti 2019</i>	<i>Viti 2018</i>
Te ardhura nga shitja e mallrave	925,246,617	936,248,620
Te ardhura nga sherbimet	3,160,743	2,904,857
Te ardhura nga shitja e garancive per produktet	10,775,428	5,036,449
Totali	939,182,788	944,189,926

14. Te ardhurat e tjera nga veprimitaria e shfrytezimit:

	<i>Viti 2019</i>	<i>Viti 2018</i>
Te ardhura te tjera	1,102,660	263,104
Totali	1,102,660	263,104

Shoqeria ka bere rakordimin e te ardhurave nga shitja sipas faturave te deklaruara ne Sistemin C@TS si dhe te ardhurat e kontabilizuara dhe te njobura per Vitin 2019 si me poshte vijon:

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
 Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

	<i>31 Dhjetor 2019</i>
Te ardhura te deklaruara sipas Sistemit informatik Tatimor C@TS	945,230,334
Te ardhura te deklaruara dhe kontabilizuara nga shoqeria per vitin 2019	937,206,646
Diferencia(+) perbehet nga si me poshte vijon :	8,023,688
<i>Te ardhura te tjera</i>	
<i>Mallra te dhene dhurante</i>	2,488,973
<i>Cregjistrime te inventarit</i>	4,267,860
<i>Ndihma per termetin e Nentor 2019</i>	350,291
<i>Diferencia te inventarit</i>	908,778
<i>Rrumbullakime te vlerave per shkak te numrit te larte te rreshtave ne Librat e Shitjes</i>	7,786
Total	0

	<i>31 Dhjetor 2019</i>
Te ardhura te tjera nga aktiviteti I shfrytezimit	
<i>Kthime te llogaritura dhe kredit nota</i>	2,011,785
<i>Te ardhura nga provigionet</i>	918,930
<i>Te ardhura te tjera</i>	148,087
Te ardhurat totale nga shfrytezimi	940,285,448
Te ardhurat nga shfrytezimi ne PASH	940,285,448
Diferencia	-

14. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Kosto e mallrave dhe sherbimeve te shitura perbehet si me poshte:

	<i>Viti 2019</i>	<i>Viti 2018</i>
Blerje mallra per shitje	565,739,972	533,157,391
Kosto e mallit te shitur llogaritur per kthimet	1,569,840	5,574,651
Totali	567,309,812	538,732,042

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

15. Shpenzime te tjera nga veprimtari e shfrytezimit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet si me poshte:

	Viti 2019	Viti 2018
Energji elektrike dhe uje	4,422,900	3,924,415
Sherbime mjekesore	95,200	-
Nafte	1,597,713	810,200
Produkte higjene	174,001	198,200
Mirembajtje international employee	32,710	-
Blerje te ndryshme	3,250,935	2,671,415
noterizime dhe konsulence ligjore	688,787	599,910
Kancelari	1,747,352	2,003,454
Kancelari international employee	52,670	-
Printime/fletepalosje	1,777,082	5,241,704
printime retail	2,185,696	-
printime WH	384,434	-
printime WH loyalty	340,485	-
Sherbim Finance	1,401,174	1,810,700
Produksioni spote	5,342,733	4,820,106
Qira	50,289,928	43,827,261
Security retail	351,412	350,583
Riparime produkte brenda garancise	58,383	39,142
Parkim	469,740	444,350
Mirembajtje dhe riparime	5,324,440	7,320,239
blerje te vogla per asete	1,057,198	1,426,705
Security, mirembajtje magazina	191,499	-
Sigurime	918,863	1,222,977
Publicitet, reklama	119,831	161,921
Teleshoping	44,697,617	47,493,352
Facebook publikime	8,648,886	8,903,911
Google publikime	2,152,026	2,350,436
Email	3,050,796	2,828,430
Marketing retail	320,728	307,212
Udhetime	1,761,724	3,931,646
Abcom call center	67,011	38,323
Internet	1,796,600	1,824,031
Telefona mobile	3,591,640	4,318,556
Postime	9,945,626	13,839,516
Për blerjet	560,276	847,000
Shpenzime për shërbimet bankare	1,210,694	-
Taksa, tarifa doganore	30,861	-
Taksa dhe tarifa vendore	1,915,095	-
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	284,493	521,830
retail qendrat tregtare	2,314,205	3,743,704
Gjoba dhe dëmshpërblime	1,736,376	87,665

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

shpenzime te panjohura	144,955	359,693
retail franchising	1,903,059	2,158,871
Shpenzime te tjera jo korente*	-	23,313
Vlera kontabel e aktive afatgjata te shitura	-	450,346
dalje jashte perdonimit asetet	-	1,177,560
Marzh shitje	-	1,516,455
Taksa dhe tarifa vendore	-	832,286
Accruals kthimet	-	1,976,143
Auditim Ligjor	-	382,000
Dalje jashte perdonimit asetet	1,499,435	
Provizione per return and sales	9,489,468	
Totali	179,396,737	176,785,561

16. Shpenzime te personelit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet e pages dhe sigurimet shoqerore si me poshte:

	Viti 2019	Viti 2018
Pagat dhe shpërbllimet e personelit	85,713,955	86,032,722
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	33,919,338	33,389,792
Totali	119,633,293	119,422,514

Numri i punonjesve me date 31 Dhjetor 2019 ka qene 140 punonjes (njeqind e dyzete).

Numri mesatar i punonjesve per 2019 eshte 137.5 punonjes. (njeqind e tridhjete e shtate pike pese)

17. Te ardhurat e shpenzimet financiare

Ne kete ze perfshihen te ardhurat dhe shpenzimet si me poshte:

	Viti 2019	Viti 2018
Shpenzime per interesa	343,184	274,931
Shpenzime bankare	0	1,084,499
Humbje nga azhornimi I arkes/bankes	112,518	502,123
Humbje nga këmbimet dhe perkthimet valutore	54,009	680,700
Totali	509,711	2,542,253

Të ardhura financiare

	Viti 2019	Viti 2018
Të ardhura nga interesat bankare	110,862	148,906
Fitime nga azhornimi i Arkes/Bankes	19,429	387,804
Fitim nga këmbimet valutore	3,495,249	7,386,897
Totali	3,625,540	7,923,607

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
 Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

18. Fitimi Neto

Fitimi neto i vtit finanziar llogaritur si me poshte:

	<i>Viti 2019</i>
Fitimi (Humbja) para tatimit	65,505,914
Shpenzimet e pazbritshme	16,174,866
Te ardhura te patatueshme	918,930
Fitimi /humbja tatile	80,761,849
Tatim Fitimi (15 %)	12,114,277
Fitimi(humbja) neto e vtit finanziar	53,391,636

Shpenzimet e pazbritshme per efekte tatile perbehen si me poshte:

	<i>Viti 2019</i>
Shpenzime te pa-suportuara me dokumente te rregullta tatile	8,657,605
Gjoba dhe demshperblime	1,736,175
Shpezime prite-perfaqesimi	137,890
Dalje jashte perdonimi te aseteve	1,499,435
Efekti ne shpenzime I zbatimit te SNRF 16	4,143,761
Total	16,174,866

19. Instrumentat financiare

- Rreziku i kredise

Vlera e mbartur e aktiveve financiare perfaqeson ekspozimin maksimal ndaj rrezikut te kredise. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut te kredise ne daten e raportimit eshte si me poshte:

2019	0-6 Muaj	6-12 Muaj	Me shume se 12 muaj	Totali
Aktive financiare				
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	29,829,071	-	-	29,829,071
Te drejta te arketueshme	-	26,379,067	-	26,379,067
Totali	29,829,071	26,379,067	-	56,208,138

- Rreziku i likuiditetit

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

Më poshtë janë maturitetet kontraktuale të detyrimeve si më poshtë:

2019	0-6 Muaj	6-12 Muaj	Nga 1 ne 5 vite	Totali
Detyrime financiare				
Detyrime ndaj furnitoreve	-	184,410,569	-	184,410,569
Detyrimet ndaj punonjesve dhe tatumore	15,314,459	-	-	15,314,459
Detyrime karta krediti	-	559,455	-	559,455
Totali	15,314,459	184,970,024	-	200,284,483

- Reziku nga monedha

Shoqeria ka ekspozim ndaj rrezikut te monedhave te huaja si me poshte :

2019	Leke	Euro	USD	Total
Aktive afatshkurtra				
Mjete monetare	20,822,165	8,832,039	174,867	29,829,071
Te arketueshme tregtare	24,482,715	1,896,352	-	26,379,067
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	1,731,500	151,444	-	1,882,944
Totali i Aktiveve afatshkurtra	47,036,379	10,879,835	174,867	58,091,082
Detyrime afatshkurtra				
Furnitore dhe detyrime te tjera	-20,441,406	-179,654,178	-188,898	-200,284,574
Totali i Detyrime afatshkurtra	-20,441,406	-179,654,178	-188,898	-200,284,574
Pozicioni neto i kursit te kembimit	26,594,973	-168,774,343	-14,031	-142,193,493

- Analiza e ndjeshmerise

Nje forcim prej 15% i Lekut ndaj Euros ne 31 Dhjetor 2019 dhe i Dollarit me 31 Dhejtore 2019 do te rriste/(ulte) kapitalet e veta dhe fitimin ose humbjen me vlerat e treguara me poshte. Kjo analize presuzozon qe te gjithe indikatoret e tjere, ne vecanti normat e interesit, te jete te pandryshuara.

2019	Kapitali	Fitim/Humbja
EUR	(25,316,165)	(25,316,165)
USD	(2,105)	(2,105)

Analiza e ndikimi nga vlera e drejte e instrumentave financiare me norme interesit te pandryshueshme

Shoqeria nuk ka ndonje instrument financier me norme interesit te pandryshueshem te klasifikuar si i mbajtur me vlerë te drejte ne fitime/humbje, dhe shoqeria nuk perdor derivative. Prandaj ndryshimet ne normat e interesit ne daten e raportimit nuk do te ndikonin fitimet ose humbjet.

20. Transaksionet me palet e lidhura

Pasqyrat financiare te konsoliduara në dispozicion të publikut preqatiten nga Studio Moderna Holdings Investments B.V., e cila është kompania kontrolluese përfundimtare e kompanisë

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
 Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)
Transaksionet me palet e lidhura

Gjate vitit 2019 kopmania ka kryer transaksione me palet e lidhura si meposhte:

	Viti 2019
	Zbritje të lejueshme
Top Shop International SA	542,422,371
Top Shop International SA	-
Studio Moderna d.o.o	4,766,299
Total	547,188,670
	Të ardhura të vlerësueshme
	5,121,432
	2,528,070
	-
	7,649,502

Shoqeria prengatit dhe deklaron ‘Njoftimin e Transaksioneve Vjetore te Kontrolluara’ ne perputhje me Ligjin Nr. 8438 date 28.12.1998 ‘Per tatimin mbi te ardhurat i ndryshuar’

21. Shenime te tjera

Kerkesat shtese te Ligji Nr 25/2018 date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” per njesite ekonomike te mesme.

Shuma e pagave që u jepet për periudhën reportuese anëtarëve të organeve ekzekutive dhe drejtuese, për shkak të përgjegjësive të tyre, duke treguar shumën gjithsej për çdo kategori të organit, paraqitet si meposhte:

Paga Bruto		Jan-19	Shk-19	Mar-19	Pri-19	Maj-19	Qer-19	Kor-19	Gus-19	Shta-19	Tet-19	Nen-19	Dhje-19	Total 2019
1	Administrata	2,714,809	2,589,528	2,578,028	3,066,530	2,658,529	2,658,529	2,658,529	2,835,256	2,806,264	2,741,113	2,743,113	9,655,863	39,706,091
2	Shitje dhe Distribucion	5,296,436	4,713,146	4,757,846	4,941,083	5,391,393	4,688,356	5,384,316	5,291,396	5,555,466	5,700,864	6,761,354	6,604,616	65,086,272
Total		8,011,245	7,302,674	7,335,874	8,007,613	8,049,922	7,346,885	8,042,845	8,126,652	8,361,730	8,441,977	9,504,467	16,260,479	104,792,363

Numri mesatar i punëmarrësve gjatë periudhës reportuese, të zërthyer sipas kategorive per vitin 2019 paraqitet si meposhte:

Nr mesatar i punonjesve	Jan-19	Shk-19	Mar-19	Pri-19	Maj-19	Qer-19	Kor-19	Gus-19	Shta-19	Tet-19	Nen-19	Dhje-19	Nr mes 2019	
1	Administrata	19	18	18	18	18	18	18	20	19	18	18	18	18.33
2	Shitje dhe Distribucion	115	119	119	118	121	127	124	121	127	123	125	128	122.00
Total		134	137	137	136	139	145	142	141	146	141	143	146	140

Tarifat e sherbimit te auditimit dhe konsulences financiare paraqiten ne vlerat sipas tabeles se meposhteme:

	Viti 2019	Viti 2018
Sherbime Auditimi	360,000	252,000
Sherbime konsulunce financiare	1,401,174	1,810,700

“Studio Moderna Albania” shpk

Shenime per Pasqyrat Financiare
Per periudhen ushtrimore te mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(shumat ne Leke)

22. Ngjarjet pas bilancit

Shoqeria Studio Moderna Albania Shpk ka nje ceshtje te hapur gjyqesore ndaj Autoritetit te Mbikqyrjes se Lojrave te Fatit per shfuqizimin e aktit administrativ, Vendimi Nr.121, date 13.09.2019.

Gjate fillimit te Marsit 2020, shfaqja e Covid-19, ne Shqiperi, ka krijuar veshtiresi ne funksionimin e bizneseve ne Shqiperi per shkak te masave te marra nga Qeveria Shqiptare per parandalimin e perhapjes se ketij virusi. Kjo ngjarje ka nje ndikim te menjehershem ne shume hallka te zinxhirit ekonomik. Deri ne daten e leshimit te ketyre pasqyrave financiare kjo ngjarje eshte konsideruar si ngjarje jo me efekte rregulluese per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019.

Nuk ka ngjarje te tjera mbas dates se raportimit te cilat mund te kerkojne rregullime apo paraqitje te informacionit ne pasqyrat financiare te Shoqerise